



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:181158
Datë: 23.04.2024
Numri i dokumentit: 05607672

PAKR.nr.700/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Afërdita Bytyqi, kryetare e kolegjit, Hashim Çollaku dhe Bashkim Hyseni, anëtar, me sekretaren juridike Fitnete Hoti, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.Z., me vendbanim në rrugën “Seni Pasha”, Mah1 Sokak nr.8 në Stamboll, për shkak të veprës penale legalizimi i përmbajtjes së rreme, nga neni 395 par.2 lidhur me par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit S.Z., av.Driton Musliu, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.282/2023, të dt.16.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.23.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit S.Z., av.Driton Musliu, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.282/2023, të dt.16.10.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.282/2023, të dt.16.10.2023, është shpallur fajtor i akuzuari S.Z., për shkak të veprës penale legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 395 par.2 lidhur me par.1 të KPK, dhe i është shqiptuar, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit është zëvendësuar në dënimin me gjobë, në shumën prej 3.000 (tremijë) Euro, të cilin dënim është obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, pas afatit prej 15 ditëve, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, atëherë i njëjti do të zëvendësohet në dënimin me burgim, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20Euro.

Është obliguar i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale, sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në emër të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 Euro, si dhe shumën prej 50 (pesëdhjetë) Euro, për kompensimin e viktimave të krimit si dhe shpenzimet e procedurës sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës.

Në kuptim të nenit 464 të KPPRK, anulohet si veprim juridik regjistrimi në sistemin elektronik, për personin Sh.Q., për faktin se regjistrimi është bërë në mënyrë të kundërligjshme.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit S.Z., av. Driton Musliu, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal dhe vendime të tjera, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i butë.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.637/2023, të datës 11.12.2023, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit S.Z., av.Driton Musliu, ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e bazuar, ashtu që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.282/2023, të dt.16.10.2023, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit S.Z., av.Driton Musliu, aktgjykimit të ankimuar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit S.Z., av.Driton Musliu, nuk është e bazuar.

Sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit S.Z., av.Driton Musliu, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, si dhe vendimeve të tjera, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë, nuk e ka vlerësuar në masë të duhur pranimin e fajësisë, nga ana e të akuzuarit, qysh në shqyrtimin fillestar, dhe vazhdimisht gjerë në fund të procedurës, mirëpo, nuk i ka vlerësuar në masë të duhur të gjitha këto rrethana, ashtu që nuk ka aplikuar dispozitat nga neni 70, 71 dhe 72 i KPK, lidhur me zbutjen e dënimit ose rrethanave lehtësuese në këtë çështje penale. Është dashur që të ketë parasysh bashkëpunimin e përgjithshëm të akuzuarit, në gjykatën, se në mënyrë vullnetare ka pranuar fajësinë, se ka shpreh keqardhje për veprën e kryer penale, kurse në këtë çështje penale rrethana rënduese gjykata e shkallës së parë nuk ka pasur.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me vendimin për sanksionin penal, si dhe vendimet e tjera, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës, si dhe nga provat e tjera personale dhe materiale. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë, në kuptim të nenit 69 lidhur me nenin 70 të KPK, i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese, sikurse janë, se i akuzuari ka pranuar fajësinë lidhur me veprën

penale që në seancën e shqyrtimit fillestar, se është penduar, lidhur me veprën e kryer, kurse rrethana rënduese ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtës, e sidomos ka pasur parasysh që ka bërë legalizimin e përmbajtjes së rreme të dokumentit publik, andaj duke i vlerësuar të gjitha këto rrethana, i ka shqiptuar dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimit.

Po ashtu kolegji, ka vlerësuar ankesën e mbrojtësi së të akuzuarit, nga cila nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, sikurse ka pretenduar mbrojtësi i të akuzuarit, andaj është i bindur se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.700/2023, të datës 23.04.2024

**Procesmbajtëse,
Fitnete Hoti**

**Anëtarët e kolegjit,
Hashim Çollaku**

**Kryetare e kolegjit,
Afërdita Bytyqi**

Bashkim Hyseni